



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 37**

**Ora: 10:00**

**Datë: 04. 09. 2020**

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Artan Asllani, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:
2. Shqytimi i Rekomandimit të Komisionit Përzgjedhës për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së.
3. Të ndryshme.

---

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

**Valdete Daka: Përshëndetje.** Mirë se keni ardhur! E keni rendin e ditës! Në këtë takim, janë të pranishëm të gjithë anëtarët. E kemi vetëm një pikë të rendit të ditës...

**Alim Rama:** Paneli përzgjedhës ende nuk e ka ba rekomandimin, kështu që njëherë ne duhet të vijmë në këtë pikë...Unë, ende se kam pa... ! S'mundemi me kalue në mbledhje pa e kryer punën paneli...

**Valdete Daka:** Paneli punën e ka përfunduar, e keni pasur në imell, raportin e zyrtares e keni. Tani, ne jemi prapë panel...

**Eshref Vishi:** Unë, këtë çështje e konsideroj formale. Teknikisht, ka qenë e pamundur të kemi kushedi çfarë raporti. E kemi një dokument që se kemi pas dje, e kemi sot. Mundet ky raport, nëse dikush nuk e ka pa, mundet për 5 minuta me e lexue dhe me e shqyrtua...dhe, ta aprovojmë pastaj...

**Alim Rama:** Unë, mendoj se secili panel pa marrë parasysh se çfarë vlerësimi merr, rekomandon për me u votue! Unë, sugjeroj që paneli të rekomandoj se a shkon më tej rekomandimi, te votoj fshehtë...

**Sami Kurteshi:** Mendoj që, diskutohet për Yllin, dhe ai të mos prezantoj...

**Ibrahim Selmanaj:** Ne procesin e kemi kryer, ka një epilog real që e kemi kryer vetë, kemi qenë komplet dhe unë mendoj që procesverbali të votohet dhe të shkojmë më tutje...

**Alim Rama:** Unë, mendoj se deri raporti nuk del, nuk ka një rekomandim. Deri sa ne e kemi këtë raport, ne jemi ende panel...Këtu mendoj se ne jemi, ende një panel sepse mund të kemi tjetër mendim...

**Sami Kurteshi:** E kemi tani një gjendje s'i e kemi, dhe për mua procesi që nga fillimi ka qenë jo bash bë rregull. Ne, e kemi ndryshue vec një pikë në rregullrore, e pikat tjera s'i kemi ndryshue. Është ba krejt KQZ-ja panel... Këtu, ka një konflikt interesi. E dyta, ndryshimin që e kemi bërë, në rastin më të mirë, ky është mendimi im, është bërë të preket dikush, dhe të mos gjendet në një pozitë më të mirë, jo ndryshe...Por, ndryshimi që është bërë, nuk ka qenë i volitshëm, na ka prue këtu...

Në aspekt të analizimit, z. Kurteshi e vlerësoi notimin në intervistim të kandidatëve s'i jo korrekt. Unë, tha z. Kurteshi në fund të diskutimit të tij, nuk e pranoj rezultatin, mendimi im është që të ndryshohet udhëzimi administrativ...

**Valdete Daka:** Është e vërtetë se këto procese janë të vështira, sepse ju së pari jeni përfaqësues politik dhe deshtëm nuk deshtëm, edhe këta kandidat kanë përkrahje politike. Duke u bazuar në përkrahje politike, ata kandidat edhe kanë përkrahje, i marrin poenat... Do ketë edhe hatërmbetje, dhe më vjen keq që përmenden edhe emra këtu, mirëpo ne kemi këta kandidat që disa s'i kemi njohtë, e disa edhe i kemi të Sekretariatit...Por, ky është realiteti! Unë, s'mund ta ndërroj realitetin sepse, KQZ është politike. Unë jam një gjyqtare, dhe ju jeni 10 anëtarë...! Ne, jemi në situatë që duhet proceduralisht, ta mbyllim këtë proces. Duhet ta mbyllim këtë, dhe t'i hapim rrugë procesit të ankimimit nga shumë kandidat. Ne, ende se kemi marrë vendimin përfundimtar, Realisht, i dimë mundësitë e secilit kandidatë, por i dimë edhe fuqitë politike të secilit. Nuk e shoh të arsyeshme ta prolongojmë procesin, por duhet ta përfundojmë...

E kemi një rekomandim, tash e kemi një rekomandim të panelit...

**Alim Rama:** E lexova raportin, dhe se nga paneli përgjatë procesit nuk ceket se është ndryshuar udhëzimi administrativ, prandaj vendimet e mira dhe të këqija duhet me u dokumentuar. Duhet të ceken datat, ndryshimet e bëra...

Më tej, lidhur me shqyrtimin e kësaj pike të vetme të kësaj mbledhje, diskutuan: Alim Rama, Valdete Daka, Sami Kurteshi, Eshref Vishi.

Sami Kurteshi, pastaj pyeti rreth procedurës të vlerësimit të kandidatëve për të hyrë në listën e ngushtë, pse është bërë me pika...?

**Vahide Behrami**, zyrtare e Lartë e Personelit: Unë, edhe dje kam shpjeguar se kjo ka qenë praktikë edhe në vitin e kaluar për pozitat e larta drejtuese. Kështu, njëjtë është bërë lista, sepse duhet të dihet, dhe kjo është edhe me rregullore se kandidatët, duhet të kenë maksimumin e pikëve, dhe kandidatët që kanë ose plotësojnë minimumin e pikëve. Pikët që janë dhënë për rrethin e ngushtë, pra është bërë për të kuptuar se, s'i është seleksionuar lista. Pra, formulari mbete s'i dëshmi në dosjet e kandidatëve. Sa i përket raportit lidhur me pikët e kandidatëve, ky është një raport që është proceduar sipas gjendjes. Janë pikët e 9 kandidatëve që janë cekur me emër e mbiemër,

**Sami Kurteshi**: A bëhet lista në bazë udhëzimit administrativ...?

**Vahide Behrami**: Po, lista bëhet në bazë të rregullore...!

**Sami Kurteshi**: A ka në rregullore një minimum që rregullon pikët, dhe një maksimum...?

**Vahide Behrami**: Po, natyrisht ka...

**Sami Kurteshi**: Ok...

**Vahide Behrami**: Më falni, paneli është përbërë konformë udhëzimit administrativ të vitit 2012, i plotësuar me vendimin që ka mundësuar formimin e panelit prej 11 anëtarëve të KQZ.

**Valdete Daka**: Ne jemi të lidhur me rregulloren, edhe pse ndoshta ka ardhur koha me i ndryshue rregulloret...!

**Çemailj Kurtishi**: Mund të them se ky panel është kryer, por në analize time mendoj që nuk kemi qenë s'i duhet në krye të detyrës. Ky votim, është për mua i diskutueshëm. Z. Kurtishi, në vazhdim e analizoi mënyrën dhe qasjen e votimit, duke dhënë mendimet e tij rreth listimit të kandidatëve, llogaritjen e poenave, s'i dhe vlerësime të tjera... Ai, tha ndër të tjera se nuk i ka pëlqyer mënyra e procedimit, s'i dhe rrjedha e procedimit të konkursit... Ai, tha se, është mirë që të votohet fshehtë për të mbyllur çdo dyshim, dhe kjo është në të mirë të procesit...

**Rifat Krasniq**: Se di a jemi anëtarë të KQZ, a jemi anëtarë të partive. Mua, s'mundet askush me ma imponue se s'i votoj. Ne s'kemi të drejtë t'i themi nëjritjetrit, pse t'i kështu, pse t'i ashtu... Nuk mund ta gjykojmë votën e njërit tjetrit se s'i ka qenë...Unë, nuk pe kuptoj ndonjërin: me marrë pjesë në panel, dhe mos me e nënshkrua raportin...

Mos ta zgjasim: ta kryejmë punën, dhe të votojmë...!

**Valdete Daka**: Ne mund ta prolongojmë, ta shtyjmë për të hënen apo të martën...por, ne këtë rekomandim duhet ta votojmë! Gjithsesi, ne sot jemi këtu për ta përfunduar këtë proces, dhe t'i hapim rrugë procesit...

Ne, nëse pajtoheni, a ta votojmë rendin e ditës ? Jemi duke folur deri më tani jashtë rendit, pra ta votojmë rendin e ditës. Kush është për këtë rend dite...?

Me 1 votë kundër dhe 1 votë abstenim, miratohet rendi i ditës.

